



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1092/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ashtu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në shumë prej 2600 (dymijë e gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se djali i kandidatit për kryetar të komunës së Prizrenit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren Shaqir Totaj gjat heshtjes zgjedhore me datën 18 Nëntor 2017 në ora 06:23 minuta përmes rrjetit social facebook ka bërë thirrje për ta votuar baban e tij kandidatin me numër 94 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime bien ndesh me nenin 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik PDK thekson se fotoja që shihet është foto familjare dhe se mbishkrimi në foto përcakton përkatësin e tij partiake nën emrin e të cilit kandidon. Andaj i njëjti kërkon nga PZAP-i që ta hudh posht ankesën.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se djali i kandidatit për kryetar të komunës së Prizrenit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren Adonis Totaj gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social facebook ka bërë fushate zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet kandidati për kryetar të komunës së Prizrenit me numër 94 Shaqir Totaj nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, ku me këtë veprim ka shkelur Kodim e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Ndërsa lidhur me pretendimet e subjektit politik PDK se postimi i bërë nuk është shkelje e heshtjes zgjedhore pasi që postimi i bërë është foto familjare dhe se mbishkrimi në foto përcakton përkatësin partiake të kandidatit në fjalë, Paneli konstaton se këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që në bazë të nenit 32 par 3, 4 dhe 5 të LZP-së subjektet politike i informojnë anëtarët, mbështetësit e tyre dhe kandidatët rreth dispozitave të këtij kodi, dhe duhet të ndermarin të gjitha hapat e nevojshme për ti parandaluar nga shkelja e këtij kodi, në të kundërtën ato mbahen përgjegjëse për shkeljen e këtij kodi

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik PDK është përgjegjëse për veprimet e tij duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohej bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se PDK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatat, që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara dhe e njëjta nuk ka ofruar prova sipas nenit 32.6 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL Anr.1092/2017 më datën 21.11.2017.



Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.